

**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

DREAMBUILDERS SH.P.K

**Neni 1
Themelimi, Emërtimi**

1.1 Sot, më datë 25/12/2021, themeluesit e mëposhtëm:

1. **Z.Drinush Çeka** shtetas shqiptar, lindur më 04/12/1967 në Peqin, banues në Peqin, mbajtës i letërnjoftimit nr. G71204044J;
2. **Z.Ervis Muça**, shtetas shqiptar, lindur më 06/02/1996, lindur në Belsh, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. J60203010U;

Kanë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me emërtimin: **Dream builders sh.p.k**

**Neni 2
Objekti**

2.1 Kryerjen e ndertimeve civile dhe rrugore, ndertimin për llogari të vet ose të treta të ndertimeve industriale, bujqesore, kryerjen e infrastruktures urbanistike, të parcelimit, kryerja e punimeve të rrugëve, ujësjesave, rrjetit të kanalizimeve, gazsjellesve, impianteve elektrike, civile dhe industriale, kryerje e punimeve në rrjetet e shpërndarjes së energjisë elektrike private dhe publike. Import- Export i automjeteve të përdorura, shitje me pakicë të automjeteve, tregtimi i pjesëve të këmbimit, automjete me porosi. Makina me qera. Instalim të impianteve termohidraulike. Rikonstruksion i pasurisë publike, asfaltime duke përfshirë dhe ato të terracave dhe hidroizolimin e tyre. Marrja për sipërfaqe të siperpërfaqeve publike dhe private të çdo lloji. Realizimi i impianteve të pastrimit, transformimit të nënprodukteve të pastrimit në qytet etj. Germime dhe me punime eventuale murature dhe betonarme. Prishja dhe punime në tokë të germuar. Prodhime materiale inerte guri. Prodhime elemente betoni e betonarme të zakonshme, gur dekorativ. Restaurimi i ndërtesave dhe monumenteve të kultures. Punime në sipërfaqe të gjelberta, parqe dhe pyje. Mirembajtja, zhvillimi i dekorit në mjedise urbane. Transporte të vecanta për llogari të vet ose të treta. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet



tregtare dhe financiare te pasurise se luajtshme dhe te paluajteshme. Tregtimin me shumice e pakice, import-eksport te artikujve te ndryshem ushqimor dhe industrial, hidrosanitar, mobiljeve, lendeve te para te perpunuara, bimeve medicinale, duraluminit, druri, te bar-kafe, restorante etj. Si dhe cdo veprimtri tjetër industriale dhe tregtare qe konsiderohet nga ortakët e nevojshme per realizimin e objektit te veprimtarise. Çdo veprimtari tjetër tregtare që lidhet në mënyre të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 2.2 Shoqëria, në mënyrë dytësore dhe jo në mënyrë direkte, dhe sidoqoftë vetëm për të përmbushur objektin tregtar të shoqërisë, mund të kryejë çdo veprimtari tregtare e financiare të cilat do të konsiderohen si të nevojshme dhe të domosdoshme
- 2.3 Shoqëria mund të ushtrojë aktivitete të tjera ndihmese ose të lidhura duke përfshirë importin dhe eksportin, si dhe te gjitha aktivitet e nevojshme dhe te domosdoshme për të përmbushur objektin e shoqërisë në përputhje me ligjin.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në Rruga Artan Lenja , Ish Fusha e aviacionit, nr i pasurise 1/643
- 3.2 Me vendimin e ortakëve mund të hapen ose mbyllen, ne Shqipëri ose jashtë, njësi sekondare, degë dhe filiale.

Neni 4


Baza Ligjore

- 4.1 Shoqëria do ta kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera të ligjit shqiptar.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria do të fillojë aktivitetin e saj pas regjistrimit pranë regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 13.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar dhe asambleja e ortakëve kanë të drejtë te vendosin prishjen e shoqërisë sipas menyres dhe parashikimeve ligjit shqiptar nr. 9901, datë 14.04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".






Neni 6
Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është në Lekë 1.000.000 (një milion) Lekë. Pjesëmarrja dhe ortakëve të shoqërisë:
1. Z. Ervis Muça, është zotërues i 1 kuote, të barabartë me masën 50% të kuotave, që përbën 50% të kapitalit fillestar të shoqërisë.
 2. Z. Drinush Çeka, është zotëruese i 1 kuote, të barabartë me masën 50% të kuotave, që përbën 50% të kapitalit fillestar të shoqërisë.

Neni 7
Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet mbi transferimin

- 7.1 Nëse një ortak vdes trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
- 7.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton Shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës te ky person tjetër.
- 7.3 Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në Asamblenë e Ortakëve.
- 7.4 Transferimi i kuotave tek palët e treta ose ndërmjet ortakëve mund të bëhet vetëm me anë të një kontrate me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet në vijim të nenin 7.5.
- 7.5 Ortakët e Shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes (oferta e parë e shoqërisë) mbi shitjen e kuotave të një ortaku tek palë të treta. Në këtë kuadër, një ortak që dëshiron të transferojë kuotat e tij (Ortaku Transferues) duhet së pari të marrë një ofertë të



parevokueshme në mirëbesim dhe me shkrim për blerjen e kuotave nga një palë e tretë dhe të njoftojë ortakun tjetër (Ortaku Jo-Transferues) me e-mail dhe me letër rekomande ose me postë të zakonshme, mbi të gjitha kushtet e transferimit të ardhshëm të kuotave të tij (Njoftimi i Transferimit) duke përfshirë-por jo vetëm: (i) emrin e ofertuesit dhe adresën, (ii) çmimin e shitjes duke vënë në dukje nëse pagesa do të bëhet në para apo në ndonjë formë tjetër dhe (iii) marrëveshjen e palës së tretë se do të respektojë Statutin e Shoqërisë.

Ortaku Jo-transferues mund të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes duke i dërguar Ortakut Transferues të Shoqërisë një njoftim të shkruar dërguar me e-mail dhe me letër rekomande ose me postë të zakonshme, brenda 40 ditëve nga marrja e Njoftimit të Transferimit (Njoftimi i Ekzekutimi). Njoftimi i Ekzekutimit duhet të paraqesë shprehimisht dëshirën e Ortakut Jo-transferues për të ushtruar të drejtën e tij të parablerjes mbi të gjitha, dhe jo më pak se të gjitha kuotat e përcaktuara në Njoftimin e Transferimit sipas kushteve të ofruara për blerje nga pala e tretë. Gjithashtu, nëse Ortaku Jo-transferues dëshiron, mund t'i dorëzojë Ortakut Transferues brenda 40 ditëve një kundër-ofertë për të cilët ky i fundit duhet të përgjigjet me shkrim me anë të e-mailit dhe postës rekomande ose postës së zakonshme brenda 15 ditëve pas marrjes së kundër-ofertës. Nëse Ortaku Jo-Transferuar ka ushtruar të drejtën e tij të parablerjes ose Ortaku Transferues ka pranuar kundër-ofertën, shitja dhe kalimi i kuotave duhet të kryen brenda 30 ditëve nga data e pranimit.

Në rast se e drejta e parablerjes nuk është ushtruar, Ortaku Transferues mund t'i transferojë kuotat por vetëm nëse shitja kryhet sipas kushteve të përmendura në Njoftimin e Transferimit dhe brenda 30 ditëve nga data e refuzimit prej Ortakut Jo-Transferues. Blerësi i kuotave merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ortakut të mëparshëm.

- 7.6 Për ngarkimin e kuotave të tij me barrë siguroese dhe/ose peng, ortakut përkatës duhet të sigurojë më parë miratimin e Asamblesë së Ortakëve në të kundër vendosja e pengut apo e barrës do të jetë e pavlefshme.
- 7.7 Një ortak nuk mund të dhurojë një pjesë apo të gjitha kuotat e tij tek një palë e tretë përvec se me miratimin e Asamblesë së Ortakëve pasi përfituesi potencial të jetë shprehur me shkrim se do të respektojë dhe zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Statuti i Shoqërisë.

Neni 8

Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet duke i ofruar për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë, me përjashtim të ndonjë pale të tretë nëse është vendosur nga ortakët në Asamblenë e Ortakëve.
- 8.2 Kontributet e ortakëve mund të konsistojnë në të gjitha format e aktiveve të lejuar nga ligji, duke përfshirë edhe kontributet në natyrë.
- 8.3 Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet financime me pagesa, me interes ose pa interes, qoftë si kontribute në kapital ose jo, edhe objekt rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Neni 9

Zvogëlimi i Kapitalit

- 9.1 Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji shqiptar.

Neni 10

Te drejtat dhe detyrat e themeluesve

- 10.1. Interesat pronësore që mund të quhen “aksion” në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.
- 10.2. Një interes pronësor në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.
- 10.3. Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.
- 10.4. Të gjithë themeluesit apo ndonjeri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke bërë hapjen e xhirrollogarive bankare, blerjen dhe dhënjen me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.
- 10.5. Çdo aksionar ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron.



10.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përçindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 11

STRUKTURA QEVERISESE

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

1. Kuvendi i aksionarëve
2. Drejtori apo Drejtorët Menaxhues.

Vendimet e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë i cili ka të drejtë të vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve përbehet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë. Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë dhe disponon një numër votash të barabarta me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.
- 11.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
 - (a) Përcaktimin e parimeve të përgjithshme të rregullave të brendshme të Shoqërisë;
 - (b) Ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (c) Caktimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
 - (d) Caktimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të miratuar dhe likuidatorëve;
 - (e) Caktimin e shpërblimit të personave të përmendur në pikat (c) dhe (d);
 - (f) Monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave të brendshme nga Administratorët përfshirë dhe përgatitjen bilanceve dhe raporteve vjetorë;
 - (g) Miratimin e bilancit dhe raporteve vjetorë
 - (h) Zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;

- (i) Ndarjen e kuotave në pjesë dhe anulimi e kuotave;
- (j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër Administratorëve;
- (k) Ristrukturimin dhe prishjen e shoqërisë;
- (l) Përcaktimin e rregullave procedurale të Asamblesë së Ortakëve;
- (m) Investimi i aktiveve në shoqëri të tjera.
- (n) Ndryshim i politikave të Shoqërisë për shpërndarjen e fitimeve ose dividendëve;
- (o) Shitja, vendosja peng apo hipotekimi i çdo titulli, të drejte ose interesi mbi aktivet ose pronat e shoqërisë me përjashtim të veprimtarisë të zakonshme të biznesit;
- (p) Dhënia e huave ose garancive ose sigurimi për çdo detyrim të palëve të treta;
- (q) Zmadhimi dhe/ose marrja e kredive dhe/ose overdraftve me bankat ose me institute të tjera financiare;
- (r) Ndryshim thelbësor i veprimtarisë ose drejtimit të Shoqërisë;
- (s) Transferimi i markave dhe çdo pronësie intelektuale të Shoqërisë ose të zotëruara nga Shoqëria në baze të licencave përkatëse;
- (t) Blerja ose marrja me qira e tokave, ambiente ose pasuritë e paluajtshme.
- (u) Cdo ceshtje tjetër sipas ligjit apo këtij Statuti.

Neni 12

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

- 12.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve do të miratohen me unanimitetin e të gjithë ortakëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori/ët të paktën një herë në vit brenda muajit Qeshor të cdo viti në selinë e Shoqërisë ose në ndonjë vend tjetër siç përshkruhet në njoftim. Asambleja e Ortakëve duhet të thirret nga Administratori/ët nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Gjithashtu, Asambleja e Ortakëve duhet të thirret nga Administratori/ët kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të

lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara

- 13.2 Gjithashtu, ortakët që përfaqësojnë të paktën 30% të totalit të votave në Asamblenë e Ortakëvemund ti kërkojnë administratorit të Shoqërisë me shkrim ose e-mail që të mbledhë Asamblenë e Ortakëve. Kërkesa duhet të përmbajë të gjitha arsyet dhe qëllimet si dhe çështjet për të cilat Asambleja e Ortakëve duhet të marrë vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë të mbledhin Asamblenë në përputhje me paragrafët 12.3 dhe 12.4 të këtij statuti.
- 13.3 Asambleja e Ortakëve thirret me njoftim me shkrim lëshuar nga administratori, njoftim i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve me letër rekomande ose faks jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së parashkikuar për mbledhjen asamblesë. Njoftimi i shkruar do të përfshihet në regjistrin e vendimeve të Asambleve të Ortakëve. Asambleja e Ortakëve mund të mbledhet gjithashtu me anë të postës elektronike sipas të njëjtave kushte dhe afate. Asambleja mbledhet në selinë e Shoqërisë por mund të mbledhet dhe në cdo vend tjetër që tregohet në njoftimin për mbledhjen e asamblesë.
- 13.4 Njoftimi për mbledhjen Asamblenë e Ortakëve duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbledhjes si dhe çështjet që do të diskutohen (rendin e ditës) dhe në rastin e një asambleje të zakonshme, njoftimi duhet të përmbajë edhe bilancet vjetore të plota dhe raportin e drejtimit.
- 13.5 Nëse data për asamblenë e ardhshme të ortakëve është caktuar në mbledhjen e fundit ku ishin pranishëm të gjithë ortakët, ortakët konsiderohen të ftuar.
- 13.6 Nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm në Asamblenë e Ortakëve, ajo mund të zhvillohet dhe të marrë vendime të vlefshme edhe pse formalitetet e përmendura më sipër nuk janë përmbushur nëse të gjithë ortakët bien dakord mbi këtë.
- 13.7 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme dhe me anë të një konsulte me shkrim të qarkulluar tek ortakët për nënshkrim nga ndonjëri prej tyre ose nga administratori nëse të gjithë ortakët miratojnë çështjet për të cilat kërkohet qëndrimi.


Neni 14

Punimet dhe Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

- 14.1 Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve nuk mund të fillojnë nëse nuk janë të pranishëm të gjithë ortakët që përfaqësojnë 100% të kapitalit pavarësisht natyrës së vendimeve për të cilat është mbledhur Asambleja.
- 14.2 Prokura me të cilën një ortak përfaqësohet në Asamble duhet të noterizohet në çdo rast dhe të paraqitet në Asamblenë e Ortakëve. Administratorët nuk duhet të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Ortakëve.
- 14.3 Çdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në Asamblenë e Ortakëve, të cilët duhet të ruajnë konfidencialitetin.
- 14.4 Ortakët e pranishëm në Asamble caktojnë me shumicë të thjeshtë votash një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person (sekretar) për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- 14.5 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Ortakëve në selinë e Shoqërisë. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Atij i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Ortakëve. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari, nga mbajtësi i procesverbalit (sekretari) si edhe cdo ortak i pranishëm në mbledhjen e Asamblesë.
- 14.6 Vendimet e marra në Asamblesë së Ortakëve mund të nënshkruhen në një dokument të vecantë dhe të ndryshëm nga procesverbali në kopje të mjaftueshme për ortakët e Shoqërisë dhe për depozitimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 14.7 Ortakët nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës dhe as përfaqësuesit e tyre të autorizuar nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë nëse Asambleja e Ortakëve merr vendimet që përmenden në Nenin 89 të ligjit shqiptar nr. 9901, datë 14.04. 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 15 Administrimi i Shoqërisë

- 15.1 Shoqërisë do të administrohet nga një ose dy administratorë të cilët si rregull veprojnë në mënyrë pavarur nga njëri tjetri në të gjitha çështjet që lidhen me administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë. Secili prej ortakëve ka të drejtë të propozojë një administrator në Shoqëri përfshi këtu edhe veten e tij.




- 15.2 Administratorët kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykojnë të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.
- 15.3 Administratori/ët mund të autorizojë/në palë të treta për ta/t'i përfaqësuar atë/ata në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.
- 15.4 Administratori/ët organizon dhe drejton të gjithë aktivitetin tregtar të Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në çdoçështje që lidhet me të në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo.
- 15.5 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve janë ato të përcaktuara në ligj, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 15.6 Administratori ka të drejtat e mëposhtme:

- (a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakëve;
- (b) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- (c) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- (d) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- (e) nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- (f) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin

marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresin procedimet;

- (i) ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (j) mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- (k) përgatitjendhe nënshkrimin e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim Asamblesë së Ortakëve;
- (l) thirrjen e Asamblesë të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse.
- (m) Kryerjen e regjistrimeve dhe dërgimin e të dhënave të detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- (n) cdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

15.7 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në cdo kohë, nga Asambelaja e Ortakëve.

15.8 Pavarësisht nenit 14.1 të Statutit, veprimet e mëposhtme kërkojnë nënshkrimin e Administratorit të Shoqërisë, në të kundërt veprimi/transaksioni/marrëveshja nuk do të jetë i detyrueshëm për Shoqërinë:

- nënshkrimi dhe zbatimi i kontratave të cilat janë të vlefshme për më shumë se 2 (dy) vjet;
- pagesa e paradhënieve nga fitimet e Shoqërisë;
- dhënia e prokurave të posaçme për realizimin e disa lloj transaksionesh ligjore;
- emërimi i stafit kryesor të Shoqërisë.

15.9 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administratorë i Shoqërisë për një afat 5 vjecar:

A. **Z.Ervis Muça**, shtetas shqiptar, lindur më 03/02/1996, në Belsh, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. J60203010U;

Neni 16
NËPUNËSIT E SHOQËRISË

16.1. Nëpunësit e Shoqërisë zgjidhen nga Drejtori. Shoqëria nuk mund të ketë më pakë se një nëpunës.

16.2. Kompetencat e nëpunësve parashihen me aktet normative të Shoqërisë si dhe në marrëveshje me Drejtorin sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera relevante.

Neni 17

Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit.

17.1 Përgjithësisht, viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën 31 Dhjetor 2021.

Neni 18

Bilanci i Shoqërisë. Kontabiliteti


18.1 Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet dhe miratohet nga Asambleja e Ortakëve me shumicë të zakonshme dhe do të përgatitet për dorëzim tek organet përkatëse. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

18.2 Librat kontabël do të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (LEK).

18.3 Shoqëria mund të marrë financim prej instituteve financiare që operojnë në Shqipëri apo jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë pjesë të kapitalit si garanci, ose mund të bjerë dakord të hipotekojë pasuri të saj të paluajtshme me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 19

Dispozitat Përfundimtare



21.1. Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër)kopje origjinale nëgjuhën shqipe, secila prej tyre me të njëjtën vlerë ligjore.

21.2. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.


21.3. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njëjtë si është aprovuar.

21.4. Për të gjitha qështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare

21.5 Ortakët themelues autorizojnë nëpërmjet këtij Statuti Z. **Ervis Muça** që të ndjekë të gjithë procedurat e nevojshme për regjistrimin e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

ORTAKËT

Ervis Muça



Drinush Çeka

